

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALBI LOGJISTIK” SHPK

Themeluesi që nënshkruan më poshtë:

Znj. Mirsa JORGANXHI, shtetase shqiptare, e bija e Edmond, e datëlindjes 22.07.1987, lindur në Tiranë dhe banuese në adresën: Rruga “Profarma” Xhamlliku/TIRANË, mbajtëse e letërnjoftimit Nr. 030860409, dhe Nr. Personal 175722052A, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Sot më datë 11.10. 2016, bazuar në vullnetin e saj të lirë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05. 2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” vendosi të themelojë Shoqërinë Tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i veprimtarisë.

Shoqëria tregtare “ALBI LOGJISTIK” SHPK ka si objekt te veprimtarisë se saj:

1. Kryerja e veprimtarise per Import dhe Export;
2. Riparim ndërtim dhe rindërtim i mjeteve te ndryshme pranë zonave doganore dhe zonave jo doganore;
3. Kryerja e tregtisë me prodhimet e veta dhe furnizimi pa ndërmjetës në vend dhe jashtë shtetit;
4. Mbajtje, magazinim, transport te mallrave te saj, ngarkim shkarkim i tyre me mjete te ndryshme parne zonave doganore dhe zonave jo doganore
5. Veprimtari transporti detar, tokësor dhe hekurudhor dhe shërbime logjistike për nevojat e veta dhe palëve të treta;
6. Agjenci Detare dhe Spedicionere;
7. Te kryej veprimtari ne zonat doganore dhe jo zona doganore për riparim mjetesh për mjetet e vet ose te palës te trete.
8. Aktivitete te ndryshme portuale;
9. Veprimtari logjistike;
10. Agjenci shitblerje pronash te luajtshme apo te paluajtshme;
11. Veprimtari sigurimi Eksportim dhe importim, si dhe tranzitim i mallrave industrialë si dhe shitja me shumicë dhe me pakicë e mallrave industrial;
12. Import-Eksport, prodhim, transport e tregtim për të tretët me materialin e vet ose te porositesit;
13. Agjensi Sigurimi.
14. Agjensi Doganore

Neni 2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

2.1. Asambleja e Përgjithshme vendosi që shoqërinë ta emërtojë: “ALBI LOGJISTIK” SHPK.



2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Nr. 4, Rruga "Skenderbej", e ndodhur ne zone kadastrale nr. 8514, pasuria e paluajtshme nr. 4/239-N.25, Durrës/Shqipëri.

2.3. Shoqëria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete, bashki apo njësi administrative të tjera të Republikës Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3. Regjimi juridik

3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave te Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

3.2. Me vendim të saj, Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm do të përshtatë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4 . Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve/Ortakut

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata ne territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror te derdhur dhe me te mirat e pasurisë se saj.


4.5. Ortaket/Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve te tyre.

4.6. Ortakët/Ortaku kanë/ka të drejtë të marrin/marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5. Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të Vetëm, sipas dispozitave të Statutit të Shoqërisë.

Kreu III KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT



Neni 6

6.1. Shoqëria tregtare "ALBI LOGJISTIK" SHPK do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 10 000 (dhjetë mijë) Lekë, e cila zotërohet tërësisht nga ortaku i vetëm.

6.2. Pjesëmarrja e ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të shoqërisë është :

- Znj. Mirsa JORGANXHI 1 (një) kuotë 10 000 (dhjetëmijë) Lekë

6.3. Transferimi i kuotës së në tërësi, ose të një pjese të saj pas pjesëtimit të saj sipas nenit 75 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) nuk mund të realizohet nën vlerën nominale të saj. Vlera nominale e kuotës e zotëruar nga ortaku i vetëm është e përcaktuar si më sipër (pika 2 e këtij neni). Vlera nominale e kuotës pas pjesëtimit përcaktohet në aktin e pjesëtimit.

Kreu IV ORGANET E SHOQERISË

Neni 7

7.1. Vendimet në Shoqëri merren nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm e shoqërisë. Këto vendime shënohen në regjistrin përkatës. Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht eksperti kontabël i regjistruar (audituesi ligjor) caktohet nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm.

7.2 Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm ka vendosur që administratori i parë i shoqërisë të jetë Znj. Mirsa JORGANXHI, shtetase shqiptare, e bija e Edmond, e datëlindjes 22.07.1987, lindur në Tiranë dhe banuese në adresën: Rruga "Profarma" Xhamlliku /TIRANË, mbajtëse e letërnjoftimit Nr. 030860409, dhe Nr. Personal I75722052A, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një mandat 5 (pesë) vjeçar.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1 Administrimi i Shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

Kreu VI DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet ortakëve të shoqërisë në përputhje me pjesët e tyre takuese.

9.2. Ky Akt shtypet dhe firmoset në 6 (gjashtë) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

9.3 Autorizohet administratori, znj. Mirsa JORGANXHI, të ndjekë procedurat e duhura për regjistrimin e kësaj shoqërie pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Për realizimin e saj, ai ka të drejtë të emërojë apo caktojë dhe persona të tjerë.



THEMELUESI

ORTAKU THEMELUES

Znj. Mirsa JORGANXHI

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Mirsa JORGANXHI', written in a cursive style. The signature is positioned below the printed name.